



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së tretë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), mbajtur më 05.07.2022.

Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës së Prishtinës, e hapi mbledhjen e tretë duke i përshëndetur të pranishmit, dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Në udhëheqjen e nënkryetarit, Alban Zogaj, është mbajtur mbledhja e radhës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Prishtinës. Në këtë takim, ku morën pjesë përfaqësuesit komunalë, përfaqësuesit e këshillave të bashkësisë, përfaqësuesit e komuniteteve, përfaqësuesit e grupeve fetare, përfaqësues nga Policia e Kosovës etj.

Kryesuesi theksoi se është privilegj që merr pjesë në këtë takim. Ai pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar ndonjë tematikë për ta vendosur si pikë e rëndit të ditës për diskutim në këshill.

Njëzëri u miratua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Prishtinës, informatë nga Policia e Kosovës;**
- 3. Kthimi i qytetarëve tanë me banim të përkohshëm në botën e jashtme, çështja e sigurisë dhe shërbimet administrative;**
- 4. Raportim mbi organizimin e aktiviteteve Manifesta 14, Prishtina 2022;**
- 5. Përgatitjet për fushatën e korrje - shirjeve në territorin e komunës;**
- 6. Të ndryshme;**

Pika e parë

Raportim mbi organizimin e aktiviteteve Manifesta 14, Prishtina 2022.

Vesa Sahatçiu theksoi se Manifesta 14, e cila fillon më 22.07.2022 dhe zgjat deri më 30 tetor, do të ketë 55 intervenime artistike, në 25 lokacione të kryeqytetit, dhe do të ketë 102 pjesëmarrës. Manifesta është ndërkombëtare, por 48% do të marrin pjesë artistë tanë kombëtarë.

Nga fillimi i mandatit e deri me tani, ne si kryeqytet jemi përgatitur për këtë organizim në të gjitha fushat, do te thotë projekti është ndërdrejtorial. Në intervenimet që kanë filluar tek ish-biblioteka "Hivzi Sulejmani", kemi siguruar leje, e cila parasheh që ky objekt të rivitalizohet në bazë të ligjeve për trashëgimi arkitektonike dhe kulturore.

Në bashkëpunim me UNDP-në dhe Manifesta 14, në takime të rregullta me kompaninë arkitektonike "Kalorati", e cila e realizon këtë projekt, kemi punuar që ky projekt të realizohet përbrenda kohës së paracaktuar nga projektuesit. Meqë projekti i cekur është afatgjatë, që ky projekt të ngërthejë në vete nevojat tona për kulturë dhe art, por dhe për përfaqësimin dhe inkuadrimit të komuniteteve lokale përreth të lagjeve në afërsi të ish-bibliotekës "Hivzi Sulejmani", që vendi të ketë karakter të komunitetit dhe të jetë i hapur për të gjithë. Projekti i dytë i madh përbrenda Manifestës, është ai që quhet "korridori i gjelbër", i cili është projekt arkitektonik që ka një zgjatje përreth 1 km e gjysme dhe e përshkon përgjatë hekurudhës nga ish-Tulltorja e qytetit e deri në afërsi të Pallatit të Rinisë. Në atë pjesë kanë filluar intervenimet për mirëmbajtje dhe kemi bashkëpunim dhe komunikim të rregullt me Ministrinë e Ambientit, që të sigurohen lejet adekuate për këtë projekt. Po ashtu, në bashkëpunim me Drejtorinë e Parqeve, kemi bërë marrëveshje me Ambasadën suedeze dhe UN- Habitat, te cilët janë financuesit kryesor dhe bartësit e projektit, ne do të sigurojmë lule dhe bimë të ndryshme, te cilat parashihihen në projekt. Po ashtu, jemi zotuar që ky projekt edhe pasi që të përfundojë Manifesta do të mirëmbahet dhe do të jetë i qasshëm për qytetarët.

Projekti tjetër është ish-Tjegullorja e qytetit, ku kemi bërë pastrimin e plotë të tjegullores dhe organizata arkitektonike me seli në Berlin "Ramllabur", ka filluar me zbatimin e projektit të tyre. Ky projekt, si të gjitha projektet tjera, përputhet ngushtë me planet afatgjata të gjelbërimit të Prishtinës dhe të inkuadrimit të lagjeve periferike. Këto janë projekte në të cilat Urbanizmi dhe Kabineti janë duke punuar intensivisht. Kemi larguar veturat tek parkingjet pa leje te "Kino Rinia", "Hamami i Prishtinës", rruga "2 Korriku", para bibliotekës "Hivzi Sulejmani". Ky trend do të vazhdojë në të gjitha pikat ku duhet lirim i hapësirave publike, për shkak se plani për lirim e hapësirave publike është në agjendën e qeverisjes Rama. Këto janë disa prej pikave, projekti është shumë i madh, ka shumë hapësira ku ka me pasur intervenime artistike.

Pika e dytë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Hetem Kupina theksoi se në mbledhjen e parafundit është shtruar një kërkesë, që çdo takim të përfundojë me konkluzion dhe ne procesverbal të jetë i shkruar konkluzioni. Të gjitha brengat e qytetareve që kanë të bëjnë me ekzekutivin komunal, do të përcillen te ta dhe ata janë të obliguar me iu kthyer përgjigje me shkrim.

Alban Zogaj u shpreh i pajtimit me parafolësin dhe kërkoi që në mbledhjet e radhës t'i kemi konkluzionet në fund.

Njëzëri u miratua ekstrakti i mbledhjes së kaluar.

Pika e tretë

Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në komunën e Prishtinës, informatë nga Policia e Kosovës.

Në këtë pike fjalën e marrin komandantë e stacioneve policore në komunën e Prishtinës.

Z. Bekim Zogiani, zv. Komandanti Stacionit Jugu në Prishtinë.

Sa i përket zonës së sigurisë në zonën e përgjegjësisë, Stacioni jugu konsiderohet e qetë dhe në kontroll, aktivitete dhe angazhimet policore janë në nivelin më të lartë të punës së tyre.

Sa i përket periudhës së 6-mujorit të parë të vitit 2022, duke bërë krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, 2021, në zonën tonë kemi një rënie të rasteve për 4%.

Disa prej veprave më të rëndësishme për të cilat kemi bërë një krahasim me periudhën e vitit të kaluar me rastet me vjedhje të rënda, ka një rënie deri në 3%, sa i përket vjedhjeve më të lehta ndaj pronës, kemi një ngritje deri në 18%, kjo ka të bëjë kryesisht me vjedhje të telefonave, kuletave nëpër qendra tregtare, nëpër autobusë etj. Një çështje e rëndësishme janë rastet e grabitjeve, ku kemi një rënie 21%, gjatë kësaj periudhe të vitit 2022 në krahasim me vitin 2021. Po ashtu, kemi rënie të aksidenteve në komunikacionin 12%. Tani me fillimin e sezonit veror janë ngritur të gjitha masat të cilat janë në fuqi për ofrimin e sigurisë në komunikacion, ofrimin për ruajtjen e qetësisë publike etj.

E falënderojmë Komunën e Prishtinës për bashkëpunimin e pandalshëm për ofrimin e kushteve më të mira në terren për qytetarët. Tani me fillim të sezonit veror kemi gjuajtje me armë nëpër ahengje të ndryshme, andaj i lusim qytetarët të festojnë siç duhet, të mos shndërrohet gëzimi në tragjedi. Sa i përket rasteve të dukurive me narkotikë, gjatë kësaj periudhe kemi një rënie rreth 12%, krahasuar me po të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në përgjithësi është një situatë e qetë dhe në kontroll.

Kapiten Avni Namani, shef i sek. Stacioni Qendra, tha se sa i përket gjendjes së sigurisë, është një gjendje me e mirë sesa vitin e kaluar. Veprat penale gjatë vitit 2021 deri në muajin qershor të vitit 2022, kemi një rënie, konkretisht -13%, veprat penale kundër jetës dhe trupit - 23%, dhunë familje -40%, vepra penale të narkotikëve minus 44%, kundër pasurisë rënie, minus 12%, të armeve minus 29%, incidente minus 21%, zbulueshmëri 51.2%, rënie të aksidenteve në trafik -13%, urdhëresa të realizuara kemi ngritje prej 72% arrestime më shume, 17 plane operative, konfiskime të armëve kemi ngritje, sulm nga qentë endacakë nuk kemi shqetësuese, mbetet zhurma 38 tiketa të shqiptuara gjatë kësaj periudhe tre lëmoshëkërkues të larguar nga vendi janë hasur në rrugë dhe janë dëbuar. Stacioni Qendër është duke i bërë planet për përgatitjet operacionale, në mënyrë që të kemi një rend dhe qetësi publike gjatë kësaj periudhe kohore. Në vlerësojmë që gjendja e sigurisë është përmirësuar me periudhën paraprake.

Kapiten Melihate Sefedini, Stacioni Veriu, "Kodra e Trimave", theksoi se gjendja e sigurisë në aspektin e përgjithshëm në rajonin policor Veriu, vlerësohet të jetë e qetë dhe e qëndrueshme. Merite për këtë është bashkëpunimin ynë i ndërsjellë me qytetarët, anëtarët e KLSP-së, prijësit fetarë e të tjerë.

Është bërë një analizë e raportit 6-mujor për vitin 2022, krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2021, kemi një ngritje të lehtë të veprave penale, ku mund të veçojmë mashtrime, vjedhje pylli, ngacmime, sulme dhe një numër shumë të madh të rasteve të dhunës në familje.

Veprat penale që kanë pësuar rënie, janë veprat penale kundër pasurisë, siç janë vjedhje të rënda, vjedhje në tentativë edhe lëndime trupore.

Siguria në trafik në rajonin tonë, ka shënuar rritje të aksidentit në trafik me dëme materiale, ndërsa kemi pasur rënie të aksidenteve të trafikut që kanë qenë me lëndime.

Rrugët "Vëllezërit Fazliu" dhe "Ilir Konushëfci", ka pasur më shumë aksidente, ku pas një analize që iu ka bërë këtyre rasteve të aksidenteve vërehet mungesa e sinjalizimeve vertikale dhe horizontale, mungesa e parkingjeve etj.

Kemi përgatitur planin operativ sezoni veror, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale, ku në këtë plan janë të inkorporuar detyrat që dalin në lidhje me bashkatdhetarët, siguria në trafik, ahengjet dhe dasmat. Stacioni policor Veri, kemi rënë në kontakt me të gjithë pronarët e sallave të dasmave dhe kemi marrë datat e caktuar se kur janë dasmat.

Artur Krasniqi, nga Kisha Protestante, tha se pasi u përmend çështja e trafikut, desha t'i pyes nëse policia e Kosovës ka bërë ndonjë plan për mjetet e reja në kryeqytet, trotinetet elektrik, që tashmë janë problem në qytet, ku ka raste të rritjeve të aksidenteve, për çka mendoj se nuk ka informacion të çartë se a hyjnë në radhët e këmbësoreve apo tek mjetet e vozitjes.

Kapiten Avni Namani, shef i sek. Stacioni Qendra, u shpreh se duke u bazuar në atë që e u tha, posaçërisht

në shesh, kemi marrë disa masa, kemi shqiptuar gjoba nëpër vendet ku iu ndalohet përdorimi, nuk e kam numrin e saktë, por në të ardhmen do të marrim masa aty ku ekziston mundësia ligjore me shqiptuar gjoba do ta bëjmë.

Alban Zogaj bëri të ditur se me ligjet aktuale që kemi në fuqi dhe me rregulloret aktuale të rregullimit të komunikacionit, në qytetin e Prishtinës këto mjete të reja lëvizëse nuk janë të parapara dhe si rezultat të dy nivelet e qeverisjes edhe niveli qendror është duke e futur në ligjin për komunikacionin funksionimin e trotineteve elektrike, por edhe ne si qeverisje lokale jemi duke punuar në rregulloren për funksionimin e këtyre mjeteve të reja, dhe në mbledhjen e radhës besoj se do ta kemi në Kuvendin e Komunës, pastaj rregullorja del në dëgjim publik dhe e votojmë si Kuvend, ku e rregullojmë në një formë përdorimin e trotineteve elektrike.

Ai kërkoi falje nga të pranishmit për shkak të largimit të tij nga mbledhja, me arsyen e disa obligimeve të tjera. Kryesimin e mbledhjes e vazhdoi z. Bajram Gecaj, këshilltar i kryetarit për siguri.

Hetem Kupina kishte një kërkesë, që të apelohej te drejtorët e drejtorive të Komunës se Prishtinës, të na përgjigjen me shkrim në pyetjet dhe kërkesat që i parashtrijmë.

Pika katër

Kthimi i qytetarëve tanë me banim të përkohshëm në botën e jashtme, çështja e sigurisë dhe shërbimet administrative.

Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, theksoi se ne si Drejtori e Administratës, jemi të përkushtuar t'i ofrojmë shërbimet administrative për secilin qytetar të komunës së Prishtinës.

Jemi në bashkëpunim të mirë me Zyrën për komunitete dhe kthim, në kuadër të Kabinetit të Kryetarit, për të ndihmuar për secilin rast që ka nevojë për pajisje me dokumentet dhe çdo shërbim tjetër administrativ. Prioritet do të jetë rifunksionalizimi i Zyrës për informim, ku do të lehtësojë shërbimet dhe informatat e drejta për qytetarët, ne raport me përgjegjësitë dhe ofrimin e shërbimeve në komunën tonë.

Jemi në procedurë të rihapjes së disa bashkësive lokale të cilat nuk kanë qenë të funksionalizuara, ku edhe Bashkësia lokale në "Tophane" do të rikthehet në shërbim të qytetarëve.

Betim Abdullahu u shpreh se Zyra komunale për komunitete dhe kthim, funksion në kuadër të Kabinetit të kryetarit të Komunës së Prishtinës, e që për qëllim ka trajtimin e çdo rast të kthimit dhe integritimit.

Nëse ka kërkesa për mërgimtarët tanë që gjenden në pushim në sezonin e verës, jemi të gatshëm që të ofrojmë shërbime sa më të mira. Ne kemi bashkëpunim shumë të mirë me Drejtorinë e Administratës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, Departamentin për Riintegrimin dhe Integrimin e të Huajve, për të ofruar shërbime sa më të mira dhe cilësore, që integrimi i tyre të jetë sa më i lehtë.

Gjithashtu, kemi marrëveshje edhe me organizata ndërkombëtare, nëse atyre u shfaqet ndonjë problem për dokumentacionet e tyre. Kemi bashkëpunim edhe me Zyrën juridike falas nëse ata dëshirojnë me marrë, që mos me u ngarkuar me ngarkesa.

Bajram Gecaj theksoi se, pasi që po flasim për sigurinë e qytetarëve, nëse nga policia kanë diçka për të shtuar në aspektin e sigurisë, i kisha lutur ta marrin fjalën.

Kapiten Melihate Sefedini, Policia e Kosovës, tha se në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, e ka përgatitur planin operativ sezonal veror, ku të gjitha detyrat dhe aktivitetet me rastin e ardhjes së bashkatdhetarëve inkorporohen brenda këtij plani.

Hetem Kupina e njoftoi drejtorin e Drejtorisë së Administratës me sfidat e bashkatdhetarëve.

Do të ju lus për të arsyetuar përkushtimin tuaj për promovimin e të drejtave të qytetarëve tregojeni vetën tani në zyrat lokale, sidomos në pjesët urbane të Prishtinës, plotësoni me punëtorë aty ku mungojnë.

Në fshatin Bardhosh në zyrën lokale punëtori është i detyruar të punojë deri në orën 10, pastaj shkon në Besi, e qytetarët duhet të kthehen. Nëse keni mundësi vetëm gjatë dy muajve të verës të mos ketë mungesë të punëtorëve.

Bersant Beka bëri të ditur se me rekrutimin e stafit të ri, që e kemi pasur më herët, në atë zyrë punëtori tashmë e ka filluar punën.

Pika e pestë

Përgatitjet për fushatën e korrje - shirjeve në territorin e komunës.

Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë i njoftoi të pranishmit me disa informata për korrje - shirjet për këtë vit, me qëllim të realizimit me sukses të procesit të korrje – shirjeve. Bëri të ditur s'është hartuar edhe një plan operativ i veprimit, i cili ka për synim realizimin e disa aktiviteteve.

Është themeluar Komisioni për përcjelljen e procesit të korrje-shirjeve, i cili fillimisht do ta bëjë verifikimin e autokombajnave, gjendjen teknike të tyre, zbatimin e të gjitha masave të sigurisë, si dhe njohja e autokombajnerëve me rregulloren e punës për korrje - shirje. , Procesi i korrje - shirjeve veç se ka filluar në disa zona dhe nëse janë kushtet e volitshme klimatike, do të përfundojë ky proces deri në fund të muajit korrik.

Sipërfaqe të mbjella me grurë janë gjithsej 685 hektarë, rendimenti mesatar sipas disa pjesëve është 2500-3000 kg për hektar, jo shumë i kënaqshëm dhe jo me pritshmërinë që kishim.

Çmimi për korrje shirje këtë vit pritet të sillet rreth 130 euro për hektar. Këto ishin disa nga të dhënat që i kemi përgatitur për ju.

Hetem Kupina pyeti se çka mundet Komuna me iu ofruar atyre si Drejtori e Bujqësisë.

Plator Gërdovci tha se është e vërtetë që të gjithë qytetarët po ballafaqohen me ngritjen e çmimeve enorme.

Drejtorja e Bujqësisë me të gjitha kapacitetet që ka dhe me atë buxhet që e ka gjetur, është duke e bërë maksimumin që të jetë sa më afër bujqve.

130 euro për hektar, po i bie rreth 30 euro më shume se vitin e kaluar. Frika ka qenë që do të jetë edhe më shumë, por sipas ngritjeve të çmimit të derivateve ne vendin tone, 30% rritje po përshtatet me ngritjet që i kemi për momentin ne vendin tonë.

Malë Gashi, ndihmësi i komandantit të zjarrfikësve kishte një pyetje për drejtorin, duke thënë se plani operativ a i parasheh edhe masat për parandalimin e zjarrit.

Nuk e di a janë bërë publike ato në Komunën e Prishtinës, edhe pse ajo dihet që është vepër penale zjarrvënja, cilat janë masat për parandalimin e përhapjes së zjarrit.

Plator Gërdovci bëri të ditur se anëtar i këtij komisioni është edhe Muharrem Beka, inspektor për mbrojtje nga zjarri. Jemi në fazën fillestare të korrje-shirjeve dhe do të apelojmë tek qytetarët edhe pas përfundimit të korrje shirjeve të mos bëhet djegia e të mbeturave në ara, sepse përveç që e dëmtojnë ambientin është edhe vepër penale.

Hetem Kupina tha se për njoftimin tuaj, ne i marrim informatat kryesisht prej stacioneve policore. Në mbledhjet e Këshillave Lokale për Siguri, e kemi marrë për obligim që t'i njoftojmë nëpërmjet fletushkave, dhe drejtpërdrejt që të kenë kujdes të mos vejnë zjarr në ara.

Do të përpiqemi maksimalisht që këtë porosi që ju po i kërkon me dërguar ne vend tek qytetarët.

Malë Gashi tha se duhet të dërgojmë njoftimet tek bujqit, që vënia e zjarrit është vepër penale dhe ndëshkohet sipas ligjit.

Mirsada Behluli - me dt. 20.06.2022 është mbajtur mbledhja e Komitetit për Komunitete, sa i përket gjendjes së sigurisë tek komunitetet jo shumicë, të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve janë deklaruar se gjendja e sigurisë është shumë e mirë dhe tani për tani nuk kanë asnjë problem. Desha të shtroj pyetje se ku mund të marrin vërtetimet se i përkasin komunitetit jo shumicë. Më parë ato vërtetime i kanë lëshuar subjektet politike, mirëpo ka pasur keqpërdorime ku për atë arsye edhe i kanë ndaluar.

Në Komitetin për Komunitete kemi ftuar drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Ilirik Musliu i cili

gjendet këtu dhe kisha me e përcjell një kërkesë në emër të banorëve të Kalabrisë që ka të bëjë me sigurinë e banorëve të cilët jetojnë në lagjen "Kalabria". Çështja ka të bëjë lidhur me linjën e autobusit 7c e cila nisët nga Kalabria vëndndalimi i parë i autobusit është tek Aleanca dhe nuk i plotëson nevojat e qytetarëve të lagjes Kalabria.

Banorët e lagjes Kalabria kërkojnë që vëndndalimi i parë i autobusit të bëhet tek rreth-rrotullimi "Flamuri", me arsyetimin se banorët e Kalabrisë dhe fëmijët e tyre nuk janë të sigurt kur kalojnë atë pjesë e cila është mjaft e rrezikshme.

Nevoja e banorëve të Kalabrisë arsyetohet me atë jo vetëm se i referohet nevojës por edhe në sigurinë e qytetarëve. Nga rrethrotullimi "Flamuri janë dy shkolla filllore, mbrapa Termokosit është shkolla filllore "Dardania", edhe në Ulpianë është shkolla filllore "Hasan Prishtina" si dhe shkolla e mesme e mjekësisë "Ali Sokoli". Vëndndalja e autobusit 7c tek rrethrotullimi "Flamuri" banorëve të lagjes Kalabria kishte me ju mundësuar qarkullimin më të sigurt dhe më të lehtë deri në QKUK. Mbikalimet ekzistuese për shkollën filllore në Dardani dhe QKUK-s nuk plotësojnë nevojat e banorëve, sidomos në orët e vona të mbrëmjes banorët nuk tentojnë të kalojnë andej për shkak se nuk ka ndriçim, është i përmbushur me bërlllok dhe në sezonin e dimrit janë të përmbytur me ujë ashtu që qytetarët nuk kanë kurrfarë sigurie për të kaluar andej. Pasi që qytetarët nga Kalabria kalojnë në rrugën e cila qon kah Veterniku dhe përmes rrugës tjetër e cila shkon nga Veterniku kah qyteti kishte qenë mirë që të shqyrtohet nga organet kompetente mundësia për vendosjen e shenjave për kalimtarë siç janë zebat në këto vendkalime për të cilat e dimë se janë ilegal d.m.th të vendosen përkohësisht deri sa të mos vendosen mbikalimet që qytetarët e Kalabrisë të jenë të sigurt deri në një masë.

z. Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se ne e kemi pasur një takim, kërkesat janë shpalosur, kemi marrë shënimet dhe jemi interesuar për ato kërkesa. Realisht, linja e autobusit për të cilin po diskutojmë, kërkesa ka qene si vënd-ndalje me qene edhe dy stacione të tjera. Jemi duke e e shqyrtuar me u bërë një tek pjesa e hotel "Baci", ku mundemi me intervenuar më shpejt, ndërsa tek pjesa e flamurit është hapësirë e cila menaxhohet nga Ministria. Ne kemi bërë kërkesë, po presim pëlqimin prej tyre. Tek pjesa e nënkalimit në lagjen "Kalabaria", kanë qenë dy kërkesa, njëra për ndriçim. Me kontratat e reja e kemi bërë, do të intervenojmë menjëherë, tjetra ka qene me ujësjellësin dhe Investimet Kapitale, e që e kemi përcjellë tek kolegët, tani po presim intervenime prej Investimeve Kapitale, pasi që nuk është në përgjegjësinë direktet në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Bajram Gecaj pyeti z. Abdullahu se a keni përgjigje në pyetjen e parë që e shtroi zonja, ku lëshohen vërtetim për përkatësi etnike.

Abdullahu bëri të ditur se këto zakonisht merren në Bashkësinë Lokale, ku ato i kanë kartelat familjare për banorët e lagjeve dhe përkatësia etnike bëhet nën betim, ne si zyrë nuk i lëshojmë këto.

Zakonisht komunitetet i kane marrë vërtetimet nga organizatat e tyre ose të partive politike, që e përcakton etninë dhe vërtetimet e B. Lokale, vërtetimet e vëndbanimit, ku përcaktohet emër mbiemër, të dhënat personale dhe përkatësia etnike që i takon. Le të drejtohen në B. Lokale ku banojnë dhe në organizatat e tyre ose të partitë politike që funksionojnë brenda kryeqytetit dhe në nivel vëndi.

Artur Krasniqi, Kisha Protestante, theksoi se do t'i ceku dy çështje në këtë takim.

E para, një shqetësim yni, shpeshherë kur ndeshemi me probleme te ndryshme në Prishtinë, ne detyrohemi me kërkuar ndihmën e policisë, ndonëse këto probleme nuk janë të policisë, por janë të Inspeksionit komunal, por është e pamundur me rënë në kontakt me Inspeksionin komunal, qoftë me shkrim qoftë me telefon, apo edhe duke shkuar fizikisht në zyrat e tyre, nuk mundesh me marrë asnjëherë përgjigje nga ta.

E dyta, ka të bëjë me çështjen e varrezave. Më vjen keq që përfaqësuesit e komuniteteve tjera fetare nuk janë sot në takim, që të diskutojmë së bashku. Në rastin tonë konkret, ne e kemi një çështje qe 5 vjet që

e diskutojmë me Komunën e Prishtinës, ne e kemi vetëm një letër shkëmbimi, po tash e 5 vjet për ne është e pamundur ta shfrytëzojmë këtë hapësirë.

Komuna e Prishtinës në vitin 2016, është përgjigjur me një vendim të Kuvendit komunal për ndarjen e një hapësire, në ende vazhdojmë me e kërkuar. Në vendim thuhet se kryetari i Komunës, Drejtoria e Kadastrit, Shërbimeve Publike dhe Urbanizimit, duhet të merren me ekzekutimin e këtij vendimi, por sot e kësaj dite nuk kemi qasje, nuk na lejohet të bëjmë asgjë në të.

Bajram Gecaj lidhur me ankesën ndaj Inspeksionit, tha se kjo Drejtori është shumë e ngarkuar, ka numër të vogël të zyrtarëve, por ne do t'ua përcjellim vërejtjen tuaj dhe do të shohim në të ardhmen se a do të jenë më efikas në këto çështje. Ndërsa në çështjen e dytë, besoj që zotëri Qorri ka përgjigjen për ju.

Habib Qorri u shpreh se ne qysh në vitin 2019, e kemi parë lokacionin që është ndarë për varrezat protestante, mirëpo për shkak të problemeve që kanë ndodhur atëherë me kontratën, kemi bërë ndërprerjen e asaj kontrate. Qe dy vjet nuk ka pasur kontratë për rrethoja të varrezave. Këtë vit jemi në procedurë të nënshkrimit të kontratës, dhe një herë do ta bëjmë verifikimin e vendimit në aspektin pronësor dhe me këtë kontrate besoj që do ta realizojmë rrethimin e varrezave.

Hetem Kupina një këshillë kishte, që në pikën e fundit, në "Të ndryshme" me e bërë pyetje dhe përgjigje. **Violeta Hasani**, KLSP Qendër, tha se që nga viti 2014 është e formuar, janë tri shtylla që e kane ndërtuar, kapiten Bekim Zogiani, Driton Imeri dhe Sami Halimi.

Kemi mbi 7 projekte, të cilat i kemi realizuar brenda komunitetit, donacione të OSBE-së, kur është ndryshuar qeverisja komunale kemi pritur ndryshime, mirëpo unë nuk po e shoh anën e komunës që dëshiron me pasur bashkëpunim me ne.

Kërkesat e mia nuk janë me u bërë këtu dhe me mbetur këtu. Janë dy kafeteri "Strepdepo" dhe "Jurnal", janë shumë të zhurmshme. Ne e dimë që deri në orën 22:00 lejohet, por zërin e muzikës e kane jashtë mase të lartë.

Kërkesa tjetër, frigoriferët e qoshqeve që i kanë larguar, jam për largimin e tyre, por jo të mos e lejon vetëm një, sepse është shumë vështirë të punohet nga vapa me frigorifer brenda.

Ndryshim total që po e shohim dhe kemi falënderim jashtëzakonisht të madh për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, sepse në ish-qeverisjen e kaluar problemin kryesor KLSP Qendër e ka pasur me drejtoreshën Medina Braha, e vetmja gjë që e kemi nga ish-drejtoresha, e kemi problemin me "Prishtina Parkingu". Kam kërkuar në mbledhjen e kaluar me u pezulluar vendimi, ose me u marrë vendimi për të gjitha lagjet njëjtë, e jo diku me u pezulluar e diku jo.

Bajram Gecaj bëri të ditur se për çështjen e zhurmës sot është diskutuar me drejtorët, do të nxierrët rregullorja, Komuna e ka kontraktuar një organizatë, e cila do te na i siguroj 1000 matës, te cilët do të instalohen në secilin lokal, që do ta matin zhurmën. Rregulloret marrin kohë derisa të aprovohen, sepse tani për tani nuk kemi rregullore për matjen e zhurmës. Në të ardhmen do ta kemi më të lehtë me rregullore, është duke u punuar shumë për këtë rregullore.

Izedin Bajrami paraqiti shqetësimin e banoreve të rrugës "UCK", banorët e ndërtesave nuk është e mundur ta shfrytëzojnë hapësirën e tyre, sepse janë mbushur me mbeturina dhe me personat që përdorin lëndë narkotike, andaj kërkohet nga Komuna që ta bëjë pastrimin dhe rregullimin e asaj hapësire. Njëherësh, kërkohet dhe nga policia që të bëjë kontrollime herë pas here.

Bajram Gecaj i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, duke shpresuar se takimet do të vazhdojnë në këtë mënyrë, që do të ndikojnë në përmirësimin e sigurisë së qytetarëve të komunës së Prishtinës. Njëherësh ju shprehu falënderim për pjesëmarrje në punëtorinë e mbajtur te Parku i Arinjve, janë identifikuar rreziqet, ka qenë një takim me përmbajtje shumë të mirë. Ai i sugjeroi të pranishmit që të marrin pjesë edhe në takimin e radhës që do të mbahet, sepse do t'iu qasemi atyre rreziqeve që i kemi identifikuar.

Proces Mbajtësja:

Edona Krasniqi



Kryetari i Komunës

Përparim Rama

